



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
NJËSIA E PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2018

**Lënda:** Shtojcë mbi Modifikimin dhe ndryshimin e Dokumentave Standarte Të Tenderit

Sot më datë 05.12.2018, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Në bazë të Nenit 42 pika 2, të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut VII Neni 62, kreu X, neni 78, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, per procedurën **E hapur mbi kufirin e lartë monetar** te prokurimit me objekt: **“Loti i III-te” Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Perendimore**, REF-94217-11-14-2018, me fond **109 275 286** (Njëqind e nentemilion e dyqind e shtatedhjetë e pesemije e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) leke pa tvsh, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë së Shkodër, në respektim të afateve të ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik pas ankeses së ardhur me datë 21.11.2018 nga një operator ekonomik, Njësia e Prokurimit, vendosi të bëjë ndryshimet përkatëse në Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit me objekt **Loti i III-te” Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Perendimore**

, si më poshtë vijon:

**1. Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimi, kapaciteti teknik pika 2.3.9.**

**ISHTE**

- Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (për pastrim, larje dhe fshirje rrugësh), (Kodi III.1.B)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Ndikimin në Mjedis (kodi III.2.A)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)

**BEHET**

- Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit sipas objektit të prokurimit, Kodi III.1.(A/B ose C)

- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)

Ju lutemi operatorëve ekonomikë që do të paraqesin ofertat e tyre për këtë procedurë të marrin për bazë Shtojcën mbi modifikimin dhe ndryshimin e Dokumentave Standarte të Tenderit në platformen elektronike të APP –së.

Sa më sipër Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 42 pika 2 dhe pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në bazë të Kreut VII , Neni 62 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, vendosi të bëjë ndryshimet në dokumentat e tenderit përmes hartimit të një shtojce e cila u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për ta.

Nisur nga ky fakt, Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 42 pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në bazë të Kreut VII , Neni 62 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, vendosi të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 14(katermbdhjete) ditë kalendarike koha qe procedura e prokurimit ka qene e pezulluar ne SPE.

Njësia e Prokurimit njofton të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës se afati kohor për dorëzimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt:**Loti i III-te”Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Perendimore”**, është si më poshtë vijon:

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**  
**Data: 21.01.2019, Ora: 10:00**

**Vendi:** Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**  
**Data: 21.01.2019, Ora: 10:00**

**Vendi:** Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)